



Republika e Kosovës
Republika Kosova -- Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KOMUNA MITROVICA E VERIUT OPŠTINA SEVERNA MITROVICA			
MITROVICA NORTH MUNICIPALITY			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit.	10	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	10-030/01-0014364/25
Nr. i fakteve Br. Stranica	13	Data Datum Date	29.08.2025



Komuna e Mitrovicës Veriore
Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North

PROCESVERBAL NGA SEANCA E 43 - të E RREGULLT E KUVENDIT KOMUNAL TË MITROVICËS VERIORE

Kuvendi Komunal

Nr.10-030/01-0012004/25, dt. 24.07.2025

Të pranishëm:

Antarët e kuvendit: Nedzad Ugljanin, Skender Sadiku, Flutura Hamza Azemi, Naxhije Xhema, Lumni Khaka, Dusan Milunovic, Adelisa Gjushinca, Jahir Demaku, Betim Osmani, Gzim Alushi, Petrit Miftari, Arben Ismajli

Kryetari i Komunes: Erden Atiq

Nënkryetarja e Komunës: Katarina Adjancic

Drejtoresha e financave : Mevlude Shala

Drejtoresha shërbimeve publike dhe infrastrukture: Erza Mustafa

Përfaqësues të shoqërisë civile

Përfaqësues të OSBE – së,

Përfaqësues të UNMIK – ut,

Përfaqësues të KFOR- it

Mediat.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit z.Nedzat Ugljanin, ku si fillimi përshëndeti të pranishmit.

Kryesuesi: I nderuar Kryetarë, e nderuara nënkryetare, të nderuar mysafir të pranishëm, media dhe misione ndërkombëtare.

Kemi rendin e ditës me këto pika

Rendi ditës

1.Miratimi i procesverbalit nga seanca e 42-te e Kuvendit Komunal

2.Kërkesat e qytetareve

3.Raporti gjashtëmujor financiar Janar-Qershor 2025

4.Miratimi i kërkesës për ndarjen e mjeteve buxhetore për kompensimin të shpenzimeve të shujtës në vlerë prej 5 Euro nga muaji Janar 2023 deri me 31 Dhjetor 2026.

5.Vendimi me ndryshime (sipas rekomandimeve të Ministrisë) për mbështetje financiare për “Vendosjen e skulpturës nga skulptori Sabri Behramaj”

- 6.Rregullore Komunale me ndryshime (sipas rekomandimeve te Ministrisë)
- 7.Raporti gjashtëmuor i Kryetarit te Komunës
- 8.Raporti gjashtëmuor i K.K të Mitrovicës Veriore
- 9.Raporti gjashtëmuor i zv.Kryesuesit për Komunitete
- 10.Raporti gjashtëmuor i Komitetit për Komunitete
- 11.Kërkesa për rialokimin e mjeteve në kategorinë ekonomike Investime Kapitale brenda nënprogramit “Infrastruktura Publike (18198)”
- 12.Raporti i jashtëm i auditimit dhe plani i veprimit
- 13.Kërkes për transferimin e 20 pozitave të stafit nga kodi buxhetor 75170 në kodin buxhetor 85117 për vitin fiskal 2025
- 14.Të ndryshme.

Kryesuesi: Paraqet kërkesën për Miratimi i kërkesës për ndarjen e mjeteve buxhetore për kompensimin të shpenzimeve të shujtës në vlerë prej 5 Euro nga muaji Janar 2023 deri me 31 Dhjetor 2026, kjo kërkes bëhet për të gjithë të punësuarit për zyrtarët publik për ditë pune, duke përfshir dhe të zgjedhurit. Duke pasur parasysh që këto kategori të zyrtarëve publik kan pagë të ulët dhe duke pas parasysh rritjen e çmimeve kuvendi komunal do të merr vendim me të cilin mundësohet realizimi i kësaj kërkesë, gjithashtu konsiderojm së kategorit e zyrtarëve të lartshënuar meritojn përkrahje, duke pasur parasysh se kategorit e nënpunësëve zyrtar dhe institucionet tjera në Kosovë janë përfitues edhe të shtesave dhe benefiteve tjera, ndërsa kategorit e zyrtarëve publikë në Mitrovicën Veriore nuk kan qenë të përkrahur dhe përfitues në raport me komunat tjera në nivel vendi duke përfshir sektorin e arsimit, shëndetësi dhe administratës komunale ku kërkoj nga asamblesitat që këtë propozim vendim të përkahin.

Betimi: Përshendetje për të gjithë besoj se askush nuk është kundër kësaj pike që keni propozuar, por besoj se kjo pikë ka kosto dhe ne nuk e dijm sa është kosto e saj, dhe të hyjë në rend dite pa pas dokumente adekuate se sa i kushton komunës dhe sa është numri i përfitueseve besoj se nuk ja vlen të hyjë në rend dite.

Kryesuesi: Ju e dini Betim se prej momentit që kemi marrë ne detyrën ne vitin 2022 ne nga 2.5 Milion euro deri në 3 Milion po kthehen, ku për 3 vite kemi humbur 7.5 Milion, një buxhet vjetor apo më shumë, e di se këto mjete janë në drejtim të shëndetësis dhe arsimit ne asnjëherë s’kemi marrë përgjigje nga MAPL apo nga Ministria e Financave se qfarë bëhet me ato mjete apo si orientohen, sepse para neve ato mjete janë realizu, unë kam pasur takime me tjera komuna të pjesës veriore do ta marrin këtë vendim të përcaktuar sepse spo kërkohet kompenzim, siq e dini shujtat në pjesën jugore vetëm se janë duke u realizuar, ne duhet te sjellim këtë vendim, në komunën Shtërpce kuvendi komunal kur kan miratu vendimin kan përfitu të gjithë të punësuarit

Dushani: Kërkesa ime ishte që pika për “Kërkesat e qytetarëve” me qenë si pikë e dytë, dhe shohë që kemi këtu qytetarë dhe propozoj që ti ndëgjojm kërkesat e tyre.

Betimi: Nëse po vendosim të ndërtoj rendin e ditës propozoj që pikat që janë për të votuar të kalojnë në fillim, kurse raportet gjashtëmuore të mbesin në fund, mendoj se është më mirë.

Kryesuesi: Kërkesat e qytetarëve, dhe kërkesa për shujta do jenë në fillim, kurse të tjerat janë me radhë, dhe e hedh në votim për këtë rend dite, kush është për këtë propozim ?

Rendi i ditës votohet 10 janë për dhe 2 kundër.

Skenderi: A mundem të sqaroj pse jam kundër këtij votimi për rend dite, propozim vendimi është në rregull, por vjen me datë 28.07 dhe sot është 29.07 nuk është korrekt dhe baza ligjore duhet të jetë më mirë, nëse kjo ka qenë procedur që është ditur më parë është mirë që me pas bazën ligjore që me dit ku është konsultu me pjesën e brendshme, për këtë arsye me datë të ditës së kaluar dhe të vijë sot dhe jo me material përcjellës edhe pse vjen me vones është dashur të jetë pjesë dhe me e elaboruar me kosto.

Kryesuesi: Ju njoftoj për miratimin e procesverbalit nga cdo seancë, kushdo që është kundër të jap dhe arsyet apo vërejtjet e tyre.

Betimi: Sa herë që ne nuk kemi votu kemi kërkuar të marim fjalën dhe të japim arsyet tona pse nuk është votuar, kjo rregullore ka qenë gjithmonë se dhe kur voton kundër te japim arsyen pse jemi kundër, nuk është diçka e re por ka qenë gjithmonë, dhe në këtë rast që votova kundër keti vendimi për shujta mendoj se nuk është logjike që të marim vendim të votojm për diçka që nuk dijm as koston.

Kryesuesi: Vazhdojm me pikën e parë miratimi i procesverbalit, kush është për votim ?
Procesverbali votohet me 10 vota për, 1 kundër, 1 abstenim.

Betimi: A mundem të sqaroj pse vota ime është kundër, sepse procesverbali ka ardhë me vones që është dashtë të vijë më herët, dhe vërejtja tjetër është se nuk e kam lexuar akoma, unë kam votuar gjithmonë kundër sepse kam pas vërejtjet e mia në përmbajtjen e procesit, sepse nuk është shkruar ajo qfare ne kemi diskutuar, tash shpresoj të jetë më mirë.

Skenderi: Statuti, ligji deri te kushtetua, materiali i mbledhjes duhet të jetë së paku 7 ditë më herët me material përcjellës, nëse është pyetje plani i veprimt duhet ta kemi një javë më herët, jo vetëm ne por publiku mediat dhe te gjithë.

Kryesuesi: Me propozimin e Dushanit si asamblesit pika e dytë është kërkesat e qytetareve.

Skenderi: Me vjen mirë që këtu është dhe Kryetari dhe në fillim kur kemi ardh ne është bërë një punë e madhe, dhe për veprime të mira duhet të lavdërohet komuna jonë është shembull, kemi qenë të rrethuar me gilindera dhe ka qenë një fjalim që kam thënë qfar është kjo kështu mos jemi duke u friksuar nga qytetaret, komuna është hapur dhe brendia e komunës është model, tani them kryetarit se kërkesat e qytetareve nuk duhet të kthehen sepse nuk janë absurde, tani më me urgjenc është qështja e taksive, nga fillimi që jemi këtu rregullorja komunale e cila ka qenë model që është punuar në bazë të grupeve të interesit ka qenë pjesëmarrës në fillim taksist, autotaksit që kemi bisedu dhe ka qenë drejtori i inspeksionit Z.Fatir, nënkryetarja kam qenë edhe unë, cdo fjalë që është në rregulloren komunale me besoni është në mënyrën më të mirë, dhe qfarë kthehet sot zyrtari i cili nuk e pranon një kërkes të qytetarit është për turp, dhe nëse vijn kërkesat prej dy taksive kjo është për brengosje, dhe nuk guxojm ta lejojm dhe duhet që cdo kërkes të pranohet, kërkoj që edhe taksistave të ju jepet fjala dhe ti ndëgjojm brengat e tyre, unë do e lexoj dy kërkesat e taksive dhe që janë tek ne.
Fillon të lexoj kërkesat e tyre

Si qytetar ndjej keqardhje si mos të meret kërkesa, ne qfar jemi duke diskutuar janë pjesë shtesë, kërkesa duhet të meret dhe të pergjigjet ne bazë ligjore dhe ne afat ligjor.

Qytetaret (Përfaqesuesit e kompanis të taksive) Përshendetje kërkesat tona si kompani taksistave që të licensohemi nga komuna, neve na është thënë nga organet kompetente të komunës se cilat janë dokumentet për licensim, por nuk kan jap dokumente me shkrim, e gjitha ka qenë gojarisht, ne kemi arrit të mbledhim disa dokumente për licensim dhe kemi marr pergjigje se na refuzohet kërkesa e licensimit, për shkak të mos përmbushjes së kriterëve, ne kemi pranuar rregulloren e komunës, kemi ardhë këtu me parashtrur nje lutje që të na jepet me shkrim se qfar dokumente na duhen për licensim.

Diskutojn lidhur me kërkesën e kompanive te taksive ne Mitrovicen Veriore

Erdeni: Të nderuar të pranishëm unë nuk e kam qenë në njohuri që ka me qenë si pikë e rendit të ditës, dhe nuk jam i përgatitur me detaje në përgjithësi, pasi qe koleget e mi kan përfunduar punën në orën 16:00 neser në mëngjes do të shohë me ekipen time se ku qëndron problemi a kanë ndonjë përgjigje, përndryshe nesër mundemi të takohemi në orën 15:00 nëse juve ju përshtatet dhe do te ju pergjigjem për temat të cilat jam i njoftuar sot këtu, atëherë nesër ne ora 15:00 takohemi këtu.

Skenderi: Janë kërkesat që shpresoj që deri sa egziston drejtoria për shëndetësi ne mund të votojm por jemi duke kaluar në një drejtori të rëndësishme dhe pothuajse gjitha kërkesat kan të bëjnë me shëndetësi, kërkesa që janë paraqit shkaqet shëndetësore jan me diagnoz, mirëpo nuk guxojm të marim përgjegjësi profesionistave, të gjitha këto kërkesa mirë do ishte të dorëzohen në drejtorin e shëndetësis dhe të shohin se cilët janë me prioritet dhe të japim nga pjesa jonë, mos të votojm diçka që nuk është në profesion tonin.

Kryesuesi:Këto janë subvencionet e kuvendit, ne kemi të drejt të votojm, ku të gjitha mjetet e arsimit dhe shëndetësis po na kthehen mrapa, për këto raste mjetet qe smundemi ti përdorim ti ndihmojm personave me nevoj me qenëse kemi ndihmuar shume raste.

Skenderi:Ne nuk jemi mjek, komuna ju ka ndarë drejtorisë së shëndetësis buxhet për shëndetësi, ne nuk guxojm të marim përgjegjësin e mjekut, si mund të votojm ne diçka qe nuk e dijm se ne nuk jemi mjek dhe nuk e dijm se nga qfar vuajn me shëndet, te gjitha janë kërkesa për trajtim shëndetësor, është temë e ndishme dhe nëse kemi buxhet tepër po mund te ndihmojm, por të marim një mendim nga profesionistët.

Kryesuesi: Këtu kemi dy raste të cilët janë me hemoterapi që smund të lëviz, dhe ne kemi të drejt me vendos sepse kemi nga subvencionet tona te kuvendit që janë shpenzuar 3000 Euro dhe kemi edhe 7000 Euro tjera që mund të ndihmojm qytetarët në nevoj, dhe propozoj që këtyre kerkresave që kanë nevoj për ndihm të ndajm mjete me vler 500 euro, kush jeni për votim ?

Naxhije: Kryesues a ka mundësi emrat që kan bërë kërkes?

Kryesuesi: Kërkesat jan nga: Naim Berisha, Meliq Pazari, Jeton Vidishiqi, Mirsad Maliq dhe Shpresa Kaqapor, janë këta persona që kan bërë kërkes për ndihm shëndetësore, këta kan bërë

kërkes me von jo kur ka qen i hapur aplikimi, ju lutem te hyjë në votim dhe ti ndajm mjetet për këto raste që jan me sëmundje, ne kemi pas raste kur kemi mbështet financiarisht për shëndetësi edhe më parë, ne nuk kërkojm nga zyra kryetarit apo nga zyra financave por nga subvencioneve të kuvendit.

Naxhije: Përshendetje për të gjithë, unë si kryesuese e komitetit për komunitete kërkesat e qytetareve i trajtojm të gjitha kërkesat e qytetarëve në komitet, unë votoj për të gjithë ata qytetarë që ballafaqohen me sëmundje të rënda jam për pro, kurse për ata qe janë me sëmundje me te lehta ndoshta kishte me qenë mire ekzekutivi apo dikush tjetër të meret me ta.

Kryesuesi: Cdo kërkes që vjen tek ne, se pari kalon tek komiteti per komunitete që drejtohet tek ju, por e dini se po perballehmi me një problem të mos funksionalizimit te këtij komisioni sepse sa e di nuk është mbajtur mbledhja për shkak të mos pagesës së anëtareve dhe për atë nuk kishte kuorum

Kryesuesi: E hedhë në votim për ndarjen e mjeteve për ndihm financiare me nga 500 euro për 5 persona.

Votohet me 10 vota per, dhe 1 kunder

Kryesuesi: Pas këtij votimi shkojm me 10 min pauzë.

Skenderi: Kur kemi votuar për qerdhe të fëmijëve ajo land është në prokurori, edhe këtu po dal në pozit të keqe ku bamirësia nuk bëhet duke shkel ligjin, keni votuar në rregull, por kam prit që kur mori fjalën Znj Naxhije të tregon se një komitet afër 1 vit nuk janë të paguar antarët e komitetit.

Mevlude: I nderuar kryesues i kuvendit, i ndruar kryetar, e nderuara nënkryetare, të nderuar asambleist, jam këtu sot para jush për të paraqitur raportin financiar Janar-Qershor 2025, duke u bazuar në ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit ku na obligon që të përgatisim dhe të dorëzojm kuvendit komunal raportet financiare periodike, ky proces kontriboon në transparencë dhe llogaridhënie duke mundësuar që të gjitha palët e interesuar të jenë të informuar antarët e kuvendit, mediat, qytetarët të ken qasje në informata të detajuara dhe të besueshme mbi menaxhimin e financave publike në komunën e Mitrovicës Veriore, të dhënat financiare të perfshira në këtë raport janë të gjeneruara në sistemi informativ i menaxhimit të financave të Kosovës duke ofruar një pasqyrë të qart të sakt dhe të paanshëm mbi financat dhe transaksionet financiare të komunës së Mitrovicës Veriore. Fillon te raportoj mbi raportin financiar gjashtëmujor.

Betimi: Përshendetje ne si qytetar kemi parë rrugët që janë filluar edhe pse me vones, normal kur nisemi prej pikës zero jemi më mirë tashmë, jemi në gjendje se është mirë duke u punuar, shpresoj të vazhdoni me punë dhe projekte, me vjen mirë që është edhe pastrimi i varrezave muslimane, këto punë të mira tregojn seriozitetin e institucioneve tona që kan munguar deri më tash.

Mevlude: Po është e vërtet se vetëm dy projekte skan filluar ende që janë në procedura prokurimit, deri me 1 Qershor ka pas afër 600.000 euro shpenzime, shihet edhe punë që është

duke u berë në teren dhe të bëhet më e mira e mundshme, nëse bejm krahasim me vitet e me parshme kjo komun ska raportuar asgjë nuk eshte ditur shfrytëzimi i paras publike është për tu krenuar me arritjet tona, besoj se në të ardhmen do ketë punë edhe më të mira.

Skenderi: Përshendetje për te gjithë prap një vërejte nuk na ka ardh materiali me kohë, kem nevoj për infrastruktur mirëpo po shohë dy rrugë ku njëra është me 58.000 dhe tjetra me 60.000, nëse i mbledhim dhe 600.000euro janë parashiku për këto dy projekte që nuk e di sa ka qenë projekti bazik, nëse paralogaria që është bërë më parë nuk është mirë të bije barre e komunës dhe të shtohen projekte për punë shtesë, prej kureshtjes me intereson ta di se sa ka qenë e parashikuar në rrugën e Kolashinit që duhet shtuar 60.000 euro dhe në këtë rrugën tjetër tek Kombet e bashkume pse duhet shtuar edhe 60.000 euro ku ka hasur në pengesa, duhet rregullimi i varrezave muslimane. Siq ju drejtoresh ju përmbaheni ligjit dhe këto vendime e këtij kuvendi jan ligj dhe duhet ta ndihmojm infrastrukturën.

Mevlude: Z.Sadiku ndoshta e ndërli dhe me pikën tjetër aty shihet dhe baza ligjore në kërkesën që kam bërë për rialokim duke u bazu në ligjin për ndarjen buxhetore, ku për shkak të problemeve proënsore që kan hasur nuk kan mundur të implementohet ky projekt andaj që këto mjete mos te shkojn në subvicit ju kemi drejtu kuvendit që këto mjete eksistuese ti bartim në projekte tjera që janë shumë vjeqare dhe janë projekte më të mëdha, dhe të kemi përparim të infrastrukturës në qytet.

Skenderi: Nëse ne nuk votojm për këtë rialokim atëherë rruga ku banoj unë do mbetet në gjysmë, apo e punuar keq, kush merr përgjegjësin mandej, ku nëse ne nuk votojm këto rrug dhe varrezat do mbesin keq.

Mevlude:Kërkesen që kam bërë është cek shumë mire arsyet duke u bazuar në kërkesën e drejtorisë për shërbime publike dhe infrastruktur e cila tregon problemet e mos implementimit të këtij projekti, sa për projektet që i përmend ato kan kontratë dhe kan mjete por punët shtesë që kan dal për ato nuk mundet të bëhet, përndryshe punët që janë brenda kontratës ato do realizohen sipas kontratës eksistuese, për punët shtesë nuk janë në gjendje të bëhen nëse nuk votohet ky rialokim, për të mirën e qytetit dhe te komunitetit jan dal punë shtes dhe këto mjete pse mos te shfrytëzohen ato mjete.

Erza: Isha ndërli dh edhe unë këtu meqenëse është për drejtorin që e drejtoj unë, arsyeja pse jemi duke e kërku rialokimin e mjeteve sepse është rrit volumi i punëve dhe ka pas shumë kërkesa teknike shtesë që është dashur të bëhen këto ndryshime, pasi ky buxhet nuk është duke u shfrytezu dhe të shfrytëzohet në mënyrën e duhur dhe vlen të ceket që i takojn te njëjtit nënprogram të së njëjtës kategori, dhe kjo mundëson që këto projekte të implementohen 100% dhe fondet të shfytohen komplet konform me ligjet dhe me struktur buxhetore.

Mevlude: Nëse mundem të ndërli dhem ligji për prokurim lejon që kontratat kur kan nevoj për punë shtes lejon shtimin e vlerës së kontratës prej 10%, këto projekte kan kontrat por përderi sa jan të nevojshme punë shtesë pse mos të shtohen këto mjete, përndryshe kontratat eksistojn por kemi mbules ligjore që lejon kur shihet nevoja mundet të shtohet 10% të shumës andaj kjo shumë është në suaza te ligjit.

Betimi: Nëse mundem të ndërlidhem me këtë temë, sepse merem edhe vet me biznes dhe gjithmonë ka punë shtes në qfardo lloj tenderi, nëse punohet rruga dhe ka në kërk se nëse në projekt nuk ka qen ndriqimi me këto mjete mund të bëhet ndriqim i ri apo të bëhet pastrimi i varrezave mund të bëhet një trotuar që mund të jetë punë shtesë, se nëse e vendos në ritenderim mund të jetë me kosto më të lartë, kjo është qështja që ndihmon punë kryesin dhe të bëhet me një kosto më të vogël kjo punë, Skenderi ka bërë kërkres për sanimin e ujësjellsit në lagjen Kroi i Vitakut dhe ujësjellësi e ka sanu atë problem sepse ka vendos gypin që sjell ujin në Mitrovicën e Veriut dhe Zveqan dhe ka bërë me mjete të veta për qytetaret e veriut, meqenëse ka mar menaxhim e veriut për ujësjellës

Erza: Vetëm dua të ndërlidhem me këtë që the se KRU Mitrovica tashmë ka kompetencën dhe përgjegjësin për ndërtimin e ujësjellësit në veri.

Kryesuesi: Ne po flasim për diçka që shihet në teren, çdo rrugë apo varrezat e qytetit që kemi pjesën veriore do ti përkrahim sepse gjithmonë jemi përballë me probleme me varrezat dhe sigurisht do përmirësohet gjendja, për mua nuk është problem rialokimi i mjeteve dhe kapitaleve pa marr parasysh se ku bëhen, ne vetëm kërkojm sipas planit buxhetor që Kodra Minatorëve përballat me një problem të madh që ju ka ndodhë me ujërat e zeza dhe duhet të jemi të kujdesshëm që ajo kompani të nis së shpejti punën.

Kryesuesi: Vendimi për shujtën se kemi mare ende që në fakt e keni dhe e lexova që nëse s'keni për të shtuar kalojm në votim, kush jeni për ndarjen e mjeteve buxhetore me nga 5euro për shujta Në këtë votim të pranishëm ishin 10 asamblesit dhe
Votohet me 7 vota për, 2 kunder dhe 1 abstenim

Skenderi: Deri sa nuk vjen vendimi një javë më parë dhe nuk jepet një kosto që nuk tregohet se kush na përfaqëson cilët jurista kem nevoj të bisedojm, të kemi kujdes sepse është qështje e ndjeshme që kemi të bëjm me taksat dhe pagesat e qytetarëve, mirëpo baza ligjore arsyeshmerin me kë keni biseduar kryesues, mirëpo në këtë mënyr jo nuk votoj.

Kryesuesi: Vetëm të ju shpjegoj ne kemi afatin ku sipas ligjit për vetëqeverisjen lokale ne vendimin e përcjellim në ministri, ata janë të obliguar të sjellin vendimin pozitiv apo negativ dhe sigurisht do gjejnë arsyen, do jeni të njoftuar sapa të marim një përgjigje nga ministria.

Betimi: Vetëm shpresoj që ministria në këtë formë mos të pranoj vendimet, vetëm të prezantohet me fjal dhe pa asnjë të dhënë nuk është logjike, unë e bëra një matematik të thjesht nëse janë 500 të punësuar vetëm nga 5 euro sa i kushton komunës për një vit diku afër 1 Milioon euro vetëm për shujta, është kosto e madhe të votojm për gjithë nënpunësit komunal.

Kryesuesi: Me këtë vendim nuk dëmtohet asnjë punëtor madje as komuna, unë e ceka janë ato mjete që sjan realizu, buxheti i shëndetësis, arsimit dhe për 3 vite janë kthyer në ministri mjetet, siq ka përfitu Shtërpca dhe Kamenica njësoj do përfitoj dhe Mitrovica e Veriut që përfaqësohen, ju e dini se komuna jugore i paguan shkollat dhe shëndetësinë që janë të obliguar të paguajnë nga 5 euro.

Kryesuesi: Kalojm tek pika tjetër që është për Vendimi me ndryshime (sipas rekomandimeve të Ministrisë) për mbështetje financiare për “Vendosjen e skulpturës nga skulptori Sabri Behramaj” se prej cilit kod ndahen mjetet dhe kodi është përcaktuar prej kodit buxhetor të kuvendit dhe me ndryshime është sjell në kuvend.

A mund të hyj në votim dhe kush jeni për votim?

Votohet me 10 vota për, 0 kunder, 0 abstenim

Kryesuesi: Kalojm me pikën tjetër Rregullore Komunale me ndryshime sipas rekomandimeve të Ministrisë për taksa tarifa dhe gjoba.

Flutura: Përshendetje për të gjithë, lidhur me këtë pikë kisha dashur me theksu që duke qenë të gjithë dëshmitar të gjendjes faktike këtu në kuvend kishte me qenë mirë që nga ana e ekzekutivit ka dal një deklaratë që gjitha vendimet po miren me vota të partive tjera, prej se jemi në këtë kuvend vendimet janë mar nga ne që jemi të gjithë prezent duke përfshir edhe këtë rregullore dhe cdo gjë që kemi votu me rëndësi të madhe për kuvend, mendoj që nga ana e ekzekutivit do ishte e drejt që të paktën një falënderim për të gjithë pjesëmarrësit asambleistat sepse pa neve asnjë vendim nuk kishte arrit, sepse të gjitha i kemi votuar, një falënderim është më e pakta që munden ta bëjnë sepse borgj sja kemi dhe as koalicion skemi qenë asnjëherë, më e pakta për këto vite është një falënderim sepse po e shoh gjendjen në teren që nuk po flasin spo postojn se të gjitha vendimet që janë marrë, janë me merita tona me antarët e partive tjera, sepse edhe sot edhe shumë herë tjera me një anëtar që e kanë këtu ju mungon, një e kanë dhe mungon kjo flet shumë, përveq kësaj dua dhe një pyetje kryetarit meqenëse është prezent, sepse në shumë mbledhje tjera ka munguar. Para dy viteve kam bërë një pyetje dhe i kam besuar përgjigjes që ka ardhë nga ai për puntoret e shëndetësis dhe të arsimit që ju a kanë ndal pagat kryetari patë thënë tekstualisht që për askënd nuk e shkel ligjin e tash që ka ardh nga supremja që kanë thënë se duhet të paguar, si po ndihesh tash e sa vite i ke lënë pa të hyra familjare, unë këto vite kam duru dhe kam besu në atë përgjigje që nuk e shkel ligjin, kurse tani kemi një përgjigje nga supremja dhe kjo flet shumë, faleminderit.

Kryesuesi: Ju siq e dini kur kemi mar detyrën ne kemi mar obligimin për mbrojtjen e sovranitetit të Kosovës dhe shtrirjen e ligjshmëris në pjesën veriore borgj si kemi askuj, skemi shikuar mënyra partiatike dhe falënderimet janë për të gjithë ata që kanë votuar për cdo vendim që kemi marr sidomos për rregulloret, buxhetin dhe janë disa vendime që sjan mar parasys.

Flutura: Vendimet më të rëndësishme që kanë qenë në interes të shtetit dhe që kanë ardhë në kuvendi kemi votu dhe miratu, kështu që ato sekondare spo them që se kanë peshën e vet, por ato që kanë qen më të rëndësishme të rangut të parë të gjitha i kemi votu, të gjithë e kemi shiku interesin shtetror dhe jo individual.

Kryesuesi: A mund të kalojm me pikën tjetër Rregullore Komunale me ndryshime sipas rekomandimeve të Ministrisë për taksa tarifa dhe gjoba ta hedhim në votim ?

Votohet me 10 vota për, 0 kundër, 0 absetnim

Kryesuesi: A mund të kalojm në rend dite raporti gjashtëmujor i Kryetarit të Komunes

Erdeni: Përshendetje për të gjithë të pranishmit, unë s'dua ta zgjas shumë, drejtoresha e financave dhe drejtoresha e shërbimeve publike vetëm se i ceken disa prej punëve, raportin e zyrës së kryetarit e keni edhe në ëebfaqe online më i detajuar, por cka kisha cek është mbështetja financiare ofruar qytetarëve për qështje shëndetësore dhe sociale, deri me tash janë paguar 134.000 euro për 538 familje, ndërsa shuma prej 19.450 euro për 60 familje tjera pritet të procedohet gjatë ditëve në vijim, në total janë 153.500 euro si mbështetje financiare, në ndërkohë në gjashtëmujorin e dytë të vitit do procedohen pagesat për fëmijët e lindur në vitin 2025 dhe për çiftet e reja.

Skenderi: Kryetar ky është një refleksion i mirë por prap ndoshta shkon në barr të KPF-së e kishum ditë për nder nëse raportin publik ta kishe dërguar tek ne një javë më parë, është puna jote dhe e jona publike dhe të falënderoj që në fund të mandatit ke dhënë raportin që ka qenë borgj ligjor, në mbledhjet e ardhshme ti kemi një javë me parë materialin.

Kryesuesi: Vazhdojmë me raportin gjashtëmujor të K.K ku më së shumti ka punuar zyra e kuvendit për këtë raport, ku vazhdon të raportoj mbi raportin gjashtëmujor të K.K.

Kryesuesi: Vazhdojmë me pikën tjetër raportin gjashtëmujor të i zv.Kryesuesit për Komunitete

Skenderi: Unë do të mbrohem në mënyrë që mos bëni se qfarë bëj unë por bëni se cka flas une, edhe une bashkangjitem që me vones e kam bërë raportin, dhe do ju kursej nga kjo pjesë që mos ta lexoj gjatë, me brengos fakti që ligji parasheh pozitën time i zv.Kryesues për Komunitete jo shumicë kem hy dhe po dalim nga mandati pa zyrën funksionale për komunitete dhe kthim, zyra për komunitete dhe kthim është adresa e parë ku ballafaqohen të gjitha komunitetet, në pjesën veriore ne shqiptaret jemi pakicë dhe jo shumicë dhe kjo është adresa që na duhet, ne kemi dy komitete atë për politik dhe financa dhe për komunitete që kemi votuar ne, ne kemi antarët e komiteit për komunitete që një vit nuk janë paguar dhe me ligj jemi të obliguar ta kemi këtë, keni raportin dhe shpresoj që është punuar në atë që ka qenë, dhe në pjesë të fundit na mbetet të kemi një zyre për komunitete funksionale dhe ne si pjesë politike shkojmë, kurse zyra për komunitete dhe kthim është adresa jo vetëm e komunitetit shqiptar që jem jo shumicë por këtu nuk guxojmë të harrojmë dhe komunitete tjera.

Kryesuesi: Tani kemi raportin gjashtëmujor i Komitetit për Komunitete urdhëroni Znj Naxhije

Naxhije: Dua të ndërlihem me zv kryesuesin për komunitete sa i përket qështjes së pagesës për antarët, kryesues kisha kërkuar nga ju dhe kryetari që pagesat e tyre të përfundojnë sa më shpejt sepse është për keqardhje.

Kryesuesi: Ne kemi sjell vendimin sipas ligjit kur kemi funksionuar, ata janë komisione obligative sepse sipas ligjit për vetëqeverisjen lokale, por me ndryshimin e ligjit për shërbime civil, ju siq e dini komuna tjera p.sh Mitrovica e Jugut dhe Zveqani ata i paguajnë në qfar mënyre nuk edi, por do vij rasti që ju kërkohet kthimi i mjeteve, por ne s'kemi shku kundër ligjit për shërbimin civil që ka ardhë në fuqi dhe në fakt na kanë adresu që antarët e komisionit duhet paguar nga ekzekutivi, ku gjitha komunat i kanë përfunduar pagesat e antarëve, ne kemi sjell vendimin për pages.

Naxhija: Përshendetje për të gjithë sot do e paraqes raportin gjashtëmuor i Komitetit për Komunitete Janar-Qershor 2025

Erdeni: Lidhje me pyetjen që u bë me mos pagesen e antarëve për komunitete, a kemi mar përgjigje prej MAPL për ligjshmëri, nëse është kthi ligjshmëria atëherë mundemi të paguajm prej mallrave dhe shërbimeve.

Naxhije: Unë kam biseduar me sekretaren e kuvendit dhe ajo ka mbet të interesohet në MAPL a janë procedura apo qka është qëështëja, ndoshta kryesuesi na informon më mirë edhe neve për qëshhtjen e këtij vendimi.

Kryesuesi: Nëse nuk pergjigjet ministria atëherë ajo duhet të hyjë në ploëtfuqi nëse nuk përgjigjet brenda 30 ditësh, nëse nuk janë 3 mledhje të komitetit për komunitete atëherë edhe kuvendi duhet të shpërmdahet sepse është ligj i vetëqeverisjes lokale, mos pagesa e tyre që një vit është sfide sepse s'mundemi të marim të tjerë anëtar për komunitete

Dushani: Lidhur me pagesën e anëtarëve aty e kemi një përfaqësues nga komuniteti serb si antarë dhe pajtohem me juve dhe se duhet gjetur zgjidhje që duhet të paguhen anëtarët e komitetit për komunitete.

Erdeni: Meqenëse qëshhtja është në eksekutiv me aq sa kuptova dhe pse jam laik në aspekt qëshhtjeve juridike, mbetet për të parë edhe një herë ligjshmerin dhe të sigurohemi me ministrin e punëve të brendshme dhe me vazhdu me pagesa, nuk mendoj se është diçka tepër komplekse edhe pse nuk është problem vetëm në komunën tonë, me këtë problem janë ballafaquar edhe komunat që nuk kan shku në zgjedhje të jashtëzakonshme në vitin 2023, është njëra prej pasojave që e kemi marr pushtetin pas zgjedhjeve të rregullta lokale të vitit 2021 dhe munges të shumë digastereve të mekanizmave të komunës tonë, kemi ardh deri këtu të thjeshtëojm edhe njëher dhe të shohim se cila është përgjigja definitive që mos të marim vendim të bejm pagesa para se të vërtetohet që është e ligjshme, edhe prej mallrave dhe shërbimeve dua të shohë nëse gjithcka shkon në rregull nëse marim përgjigje pozitive me procedu me pagesa.

Kryesuesi: Do shtoj ku thuhet në ligjin për vetëqeverisjen lokale se KPF dhe Komisioni për Komitete kan të drejt që gjatë vitit të bëjn 10 deri 12 mbledhje, këtu ka ardh te ndryshimi gjashtë muaj, s'mundemi të ndryshojm ligjin që vetëm për gjashtë mbledhje të paguajm, për siguri është gjashtë muaj në vit, dhe unë mbroj ligjin që është për 12 muaj.

Skenderi: Ka komuna por mos të marim modelin jo të mirë, që këto komuna që kan paguar të gjëjm modelin e tyre, unë ju flas si qytetar në momentet më kritike dhe specifike të komunës tonë nuk i kan komunat tjera, nuk i kan komunat tjera përfaqësues nga komuniteti goran, turk, boshnjak dhe serb që s'jan paguar.

Erdeni: Nëse ka komunë që ka këto defekte që i kam unë si kryetar i komunës me këtë komunë me pasoja të marrëveshjes prej Brukseli e Vjenës e që si pasojë edhe kryesuesi tha qe gjysma e buxhetit kthehet në thesar, nëse ka këso komuna me këto probleme të thella, me tregoni të mësojm nga ta, sikur kjo komune nuk është asnjë nga 38 komunat në Kosovë, njëjtin problem

kemi pasur në fillim kur kemi marr mandatin gjashtë muaj nuk janë paguar mieëmbajtëset dhe sigurimi fizik, pas gjashtë muajsh kur janë rialoku mjetet ritroaktiv kemi bërë pagesën, edhe unë do doja të mos ballafaqohemi me këto komplikime por ky është realiteti se si Erden Atiq e ka mar ekzekutivin këtu, do doja të ishim komunë e rëndomt, me buxhet të vetin dhe nuk ishin diskutu këto tema fare, jemi duke funksionu as me 50% të buxhetit vjetor dhe normal nuk krenohem me këtë dhe as nuk jemi duke u viktimizu por duhet të shohim mundësinë nëse gjitha është në rregull prej mallra dhe shërbime do i bëjm ato pagesa, ju kuptoj juve që jemi edhe në fushat mirëpo s'mundemi te zgjedhim 2-3 herë se si funksionin një komune, e herë të thirremi se jemi komunë e jashtëzakonshme etj etj, edhe ju e pranoni se nuk jemi një komun e zakonshme, dhe kjo është një ndër shumë probleme që jemi ballafaqu edhe ju si kuvend edhe unë si kryetar ekzekutivi.

Skenderi: Ne si assemble ne i kemi themelu këto komitete nuk kemi asnjë përgjegjësi vetëm një komitet, dy komitete ligji i sheh që janë obligative, ne insistojm se janë përgjegjësi e jona, sikurse që ke pas përgjegjësi me mirëmbajtës dhe me shëryes civil, i vetmi komitet që është nga ne KPF i cili nuk i ka këto specifika por e kemi këtë komitet që kemi me përfaqësues nga jashtë dhe është legjitime për një qe jem themelues, dhe nuk është për gjashtë muaj por për një vit e më shumë, jemi duke dërgu mesazh jo të mirë, brenda komitetit për komunitete kemi edhe asamblesit që me këta nuk kemi problem, po pikërisht që janë të komuniteteve të ndryshme, kemi edhe dy apo tre mbledhje dhe te mos përfundojm mandatin me borgje.

Dushani: Kam një pyetjeje kemi këtu sekretareshen a mund ta di pse këta njerëz nuk janë paguar, dhe pse ministria e punëve të mbrendshme ka të bëj me pagesën e anëtarëve për komitetin për komunitete, pse të pyesim ministrin a do jepin ata ndonjë vendim për pegesen e tyre.

Mevludë: Ligji për paga për shërbyes civil, anëtarët e jashtëm të kuvendit nuk lejohet pagesa nga buxheti i Kosoves, i kan klasifiku si anëtar vullnetar fatkeqësisht, edhe pajtohem se është e padrejt, nuk është vetëm në komunën tonë por në gjithë Kosoven, disa komuna kan vazhdu të kryejn pagesat por është rrezik i madh që mund të ju kërkohet të kthejn ato mjete, andaj si zyre e personelit në bazë të udhëzimit të ministrisë së financave i kan ndalu këto pagesa, pasi që këta antare janë klasifiku si anëtar vullnetar, janë disa modalitete që i bëjn komunat tjera që e kryejn pagesën prej mallrave dhe shërbimeve që ne e kemi mar atë model por deri sa të kthehet ligjshmëria unë s'kam ende ndonjë urdhër ekzekutiv, por sa të kthehet ligjshmëria edhe ne do i paguajm.

Kryesuesi: Më kan dërguar ministria e financave se si kan gjetur zgjidhjen ata se në qfar mënyre kan paguar, sepse ministria me ka dërguar, skam kërkuar nga kryetari i Klines, por MAPL me ka dërgu mënyrën se si është gjetur mënyra për tu paguar anëtarët e komitetit për komitete

Erden: A funksionon komuna e Klines me 50% buxhetit vjetor, a e ka mar Klina komunën në 2021 apo ne vitin 2023

Dushani: E kuptoj që punoni me 50% buxhetit vjetor por kjo nuk ka të bëjë asgjë me komitetin për komunitete, kjo është për arsimin dhe shëndetësin që kthehen në subvicit, unë e shoh që ka

tre vite që mjetet e këtyre drejtorive kthehen, gjithashtu mundesh të mbash një mbledhje me anëtarët dhe te ju tregosh për ndonjë zgjidhje.

Kryesuesi: Kërkesa për rialokimin të mjeteve në kategorinë ekonomike Investime Kapitale brenda nënprogramit “Infrastrukturë Publike(18198)” drejtoresha ka raportu dhe shihen investimet tek tregu dhe për skulpturën ku duhet të vendoset, shihen punimet por për fat të keq them se mjetet më të rëndësishme janë për varrezat muslimane në veri, edhe pse është duke u punuar nga persona vullnetar, obligimi ynë është të kemi mjetet e parashikuar me buxhet ne duhet të përkrahim këto projekte sepse ndryshimet shihen, ne si kuvend jemi të brengosur për gjendjen në Kodren e Minatorëve se dihet se si është gjendja, përkrahja është nga ministria e infrastrukturës dhe shumë shpejt sipas njoftimit nga drejtoria e infrastrukturës do nisin punimet dhe të punohet në mënyrë intenzive që është një reflektues pozitiv për ata banor që gjendja është alarmante, të hyjm për votim për këtë pikë,

Votohet me 10 vota për, 0 kundër, 0 abstenim

Kryesuesi: 10 min Pauzë

Kryesuesi: Pas pauzës vazhdojm me piken tjetër ku do raportoj Drejtoresha Mevlude Shala për “Raporti i jashtëm i auditimit dhe plani i veprimit”
Fjalën e merr drejtoresha dhe fillon te raportoj për raportin gjashtëmujor.

Dushani: Faleminderit dhe është për cdo lavdatë puna e drejtoreshës.

Mevlude: Po Dushan e vërtet që në këto kushte dhe në munges të stafit kemi arrit që të kemi transparencë dhe cdo pages që është bërë është në kuadër të ligjit dhe rregullave financiare andaj edhe unë ndihem krenare që në këto kushte kemi këtë rezultat.

Kryesuesi: Sigurisht edhe auditimi i gjenë sidomos disa mangësi ku duhet të përmirësohet në të ardhmën, sepse ne duhet të jemi të kënaqur sepse për 3 vite korrupsioni është zero në nivel komunal, por tashmë qytetarët do mësohen se ligjshmëria dhe përkushtimi ndaj saj duhet të jetë në vendin e parë, në të ardhmen do obligohen asambleistët që do marrin detyrën apo ekzekutivi që e kur të dorzojm detyrën të jemi të pastër para ligjit dhe qytetarëve.

Kryesuesi: Kalojm në pikën tjetër “Kërkes për transferimin e 20 pozitave të stafit nga kodi buxhetor 75170 në kodin buxhetor 85117 për vitin fiskal 2025” unë në fakt kam pas konsultime siq e dini ne s’jemi kundër punësimit, por jemi kundër punësimit në mënyr që është duke ndodhur dhe më së paku hapsirë kanë banorët e pjesës veriore, është hera e tretë e kësaj pike në rend të ditës dhe nuk dua të na fajësojnë neve që jemi kundër punësimit në pjesën veriore, por jam për një mbledhje të jashtzakonshme për të biseduar me ekzekutivin se cka është dhe se si të marrim masat për punësimin e këtyre 20 pozitave dhe kisha lënë në dispozicion që të mbajm së shpejti një mbledhje të jashtzakonshme për këtë pikë, kur ju të jeni dakord.

Betimi: Për këtë pikë në rend dite e ceke edhe vet që është hera e dytë apo tretë, edhe na vetëm dojm me marrë diqka në dorë që nuk na takon, cka mundemi të bëjm ne është të votojm apo mos votojm, e kë e punëson ekzekutivi besoj që janë institucionet tjera.

Erden: Komisioni është për këto punë, a bon edhe kryesuesi të sqaroj këtë akuzën se qka deshti me thën punësimi i padrejt, sqaroje se qka është akuza.

Kryesuesi: Unë e sqaroj për punësimin për zyrën për komunitete, ju e dini se si e keni përcaktu vendimin dhe vëndet e punës, sa janë nga komunitetet e ndryshme përfshir 7 persona, aty vendimi vetëm se u shkel nga ai person, sa veta janë punësu.

Erden: A keni bërë ankes?

Kryesuesi: Ne do bëjm ankes sepse s'jan të përfshir të gjitha komunitetet në kuadër të atij punësimi për zyrën për komunitete, e drejta ime është nëse votoj apo nuk e bëj kuorumin, ne duhet të ulemi dhe të bisedojm rreth qështjes së kësaj.

Erdeni: Ju po kërkon pazare a po?

Kryesuesi: Jo pazare nuk bëj me ty, asnjë her s'kam ardhë për të punësu dikë, por tjerët vijn dhe bëjn Pazar.

Erdeni: Jo tek Erden Atiq nuk ka Pazar.

Kryesuesi: Unë nuk e votoj kundër, por se plotësoj kuorumin dhe përfundon, nëse dëshironi të hyjë në votim, unë nuk e bëj kuorumin.

Dushani: Ju lutem që këtë pikë të rendit të ditës të hedhim në votim, kush dëshiron të votoj për dhe ata që votojn kundër kishte me qenë mirë të japin sqarime pse votojn kundër, sa i përket konkursit mendoj se është proces transparent, ne nuk mund të vendosim se sa do pranohen, unë sot do votoj për sepse cdo ditë takoj njerëz që kan nevoj për punë dhe konkursi është publikë dhe nuk mund te vendosë as kryetari dhe as ne si asambleist.

Kryesuesi Liron mbledhjen për të mos ketë kuorum dhe mbledhja përfundon ne orën 19:03

Procesmbajtës:

Bujar ISUFI



Kryesuesi i Kuvendit Komunal:

Nedzat UGLJANIN

